

TAKIMI I KATËRT 2023 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i katërt i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u zhvillua më datë **18.12.2023**.

Mbledhja u fokusua tek: prezantimi i ecurisë së procesit të zhvillimit të Studimit të Nevojave për Aftësi, rezultatet e përgjithshme dhe nevojat për trajnime specifike.

Në pjesën e parë të takimit, përfaqësuesja e HDCP (organizatës që do bënte Studimin) paraqiti të dhënat paraprake të Studimit të Nevojave për Aftësi. Përfaqësuesja e HDCP-së prezantoi disa nga sfidat dhe problematikat që kishte hasur studimi, gjatë fazës së realizimit të pyetësorëve me kampionimin. Gjithashtu, u prezantuan proceset vijuese pas zhvillimit të pyetësorit si: ngritja e bazës së të dhënave, përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve. Në përmbyllje të fjalës së saj, përfaqësuesja e HDCP-së prezantoi vetëm disa të dhëna paraprake, ku vlente të përmendej se në pyetësor ishin përfshirë 54 kompani nga të cilat 47 % ndodheshin në Tiranë, 29 % në bregdet dhe 24 % jashtë këtyre kategorive.

Në pjesën e dytë të takimit, përfaqësuesi i BERZH, prezantoi anëtarët e Komitetit me temat për trajnim të thelluar, të nxjerra nga intervista me secilin anëtar. Gjithashtu, u dakordësuan datat për zhvillimin e trajnimeve, që do të përqëndroheshin në njohjen e mëtejshëm të legjislacionit, misionit dhe rolit të Komitetit Sektorial, si dhe me njohjen e eksperiencave të huaja në fushë.